

Përse duhet të marrë pjesë fëmija im në HSU?

Arsye të forta


Përmes HSU-së fëmija juaj do të ...

- promovohet në shumëgjuhësi
- thellohet në gjuhën e vendit të origjinës në të folur dhe në shkrim
- forcojë identitetin e tij
- zgjerojë aftësinë e tij ndërkulturore të veprimit
- marrë pjesë në fund të nivelit sekondar I në një provim gjuhe (rezultati shënohet në dëftesë në rubrikën „Arritjet“)

Veçanërisht të kihet parasysh

Shkolla e përkushtimit është shkolla, ku zhvillohet HSU-ja.

Shkolla e detyrueshme është shkolla, e cila frekuentohet rregullisht nga nxënëset dhe nxënësit.



Partneri i kontaktit në Seksionin e Arsimit

Angela Partner
Këshillatë e shkollës
Tel. 02336 / 44 48 127
a.partner@en-kreis.de

Alwiné Ometa
Konsulente profesionale për integrimin
Tel. 02336 / 44 48 121
a.omete@en-kreis.de

Botues
Seksioni i Arsimit i Rrethit Ennepe-Ruhr

Seksioni i Arsimit të Rrethit Ennepe-Ruhr

Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës



Ecuria e procesit

Informacione për prindërit

Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës (HSU)

Mësimi në gjuhën e vendit të origjinës (HSU)

Të nderuar Prindër,

HSU-ja është një ofertë shtesë e landit NRW për nxënëset dhe nxënësit e klasave 1 deri 10 me histori imigrimi, të cilët zotërojnë tashmë **njohuritë bazë** në gjuhën e vendit të tyre të origjinës. Gjuhët dhe kultura e vendeve të tyre të origjinës të sjella me vete, janë pjesë e identitetit të tyre. Gjuhët kanë rëndësi të veçantë në zhvillimin e personalitetit të tyre. Për më tepër, shumëgjuhësia është një pasuri kulturore në një botë që rritet gjithnjë e më e fortë bashkërisht.

Mësimi zhvillohet pasditeve krahas mësimit të rregullt. Fëmijë nga shumë shkolla e zhvillojnë mësimin pjesërisht së bashku në një shkollë.

Detyrat dhe qëllimet

Detyra e mësimi është, të krijojë dhe të ruajë aftësitë e të folurit dhe të shkruarit në bazë të planit mësimor për HSU-në, dhe të përcjellë kompetencat e rëndësishme ndërkulturore.

Informacioni i shkolles

Shkolla ju informon gjerësisht juve si prindër të nxënësve dhe nxënësve me histori imigrimi lidhur me ofertën HSU.

Regjistrimi

Regjistrimet bëhen jo më vonë se fillimi i vitit shkollor ose i gjysmë vitit shkollor, - më së voni brenda 4 javësh.

Luteni të plotësoni formularin e regjistrimit dhe t'a dorëzoni atë në sekretarinë e shkollës së **detyrueshme** ose tek mësuesit e HSU-së. Regjistrimi është i vlefshëm për të paktën një vit shkollor ose deri në ndërrimin e shkollës ose deri në çregjistrim. Më pas, pjesmarrja në HSU është e detyrueshme.

Pjesmarrja e detyrueshme

Në mësim vlen (si për çdo mësim tjetër në shkollë) pjesmarrja e detyrueshme. Mungesat do të shënohen në vërtetimin mbi pjesëmarrjen.

Çregjistrimi / Ndërrimi i shkollës

Pas regjistrimit, pjesmarrja në HSU është e detyrueshme. Çregjistrimi është i mundur vetëm në fund të vitit shkollor për vitin e ardhshëm shkollor. Ai duhet të dorëzohet me shkrim në drejtorinë e shkollës së **detyrueshme** ose tek mësuesit e HSU-së. Në rastin e ndërrimit të shkollës është i nevojshëm regjistrimi i ri në shkollën e re.

Vërtetimi mbi pjesmarrjen

Vërtetimi mbi pjesmarrjen dorëzohet së bashku me dëftesën në ditën e shpërndarjes së dëftesave.

Dëftesa

Nota ose vlerësimi mbi zhvillimin mësimor të fëmijës shenohet në dëftesë në rubrikën "Shënime".

Mësuesit e HSU-së

Mësuesit që japin mësim në HSU janë punonjës të landit NRW. Ata janë të gjuhës amtare.